



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

APLIKONI NË PILOTIMIN E PROGRAMIT TË KUPONËVE

Programi do të filloj
pilotimin në tri
komuna:

1. **Komuna e Prishtinës;**
2. **Komuna e Gjilanit;**
3. **Komuna e Lipjanit.**

Aplikimi është i
hapur për **21 ditë**
nga data 23.01.2025
deri në 12.02.2025.

Programi i
Kuponëve
financohet nga
Banka Botërore dhe
do të zgjat deri në
qershor të vitit
2027.

Rreth Programit të Kuponëve

Programi i Kuponëve ka për qëllim të përmirësojë qasjen e fëmijëve 3 deri në 5 vjeç në kopshte nga familjet të cilat janë të regjistruara në Skemën e Asistencës Sociale (SAS) pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Pra, familjet e regjistruara në SAS të cilat përzgjedhen për të përfituar nga Programi, do të mund të dërgojnë fëmijët e tyre në kopshte, ku Programi do të mbuloj pagesën për kopsht dhe transportin.

Pilotimi do të zgjas 6 muaj dhe numri i kuponëve i cili do të shpërndahet në këtë fazë do të jetë 100 kuponë për 100 fëmijë.



Kush mund të aplikoj për të qenë pjesë e Programit?

- Familja e cila është e regjistruar në SAS si përfituese;
- Të ketë të paktën një fëmijë të moshës nga 3 deri në 5 vjeç në kohën e regjistrimit në kopsht. Moshë e fëmijës llogaritet nga data e ofrimit të shërbimit në institucionin parashkollor, jo nga data e aplikimit në Program. Rrjedhimisht prindi apo kujdestari ligjor mund të aplikoj edhe para se fëmija të ketë mbushur moshën 3 vjeç apo 5 vjeç, duke filluar 2 vjet e 6 muaj deri në moshën 4 vjet e 6 muaj. Me kusht që vijimi në institucion parashkollor ta nis në moshën 3 vjeçare dhe ta përfundoj kur fëmija fillon edukimin e detyrueshëm parafilior pas moshës 5 vjeçare.
- Fëmija duhet të ketë vendbanimin në komunën ku aplikon për ta vijuar kopshtin.

Si të aplikoni?

- Aplikimi bëhet përmes e-Kosova duke klikuar mbi shërbimin “Familja” dhe opsionin “Aplikimi i familjeve për përfitim nga Programi i Kuponëve” apo duke klikuar në vegëzën <https://ekosova.rks-gov.net/596>.
- Aplikuesit mund të jenë prindërit apo kujdestarët ligjorë të fëmijëve.
- Ju mund të aplikoni për më shumë se një fëmijë.
- Ju mund të zgjedhni kopshtet që janë pjesë e Programit brenda komunës suaj të banimit. Nëse banoni 4 km apo më shumë distancë nga kopshti më i afërt, atëherë ju mund të kërkonte të ju mbulohet transporti.
- **Aplikimi është i hapur për 21 ditë nga data 23.01.2025 deri në 12.02.2025.**
- Pjesëmarrja në Programin e Kuponave nuk ndikon në statusin tuaj të asistencës sociale.

Ku mund të ankoheni lidhur me Programin?

Nëse keni ndonjë **ankesë lidhur me Vendimin** për (mos) përfitim nga Programi i Kuponëve, atëherë ankesën e drejtoni në Komisionin e Ankesave të MASHTI.


Ankesa, së bashku me çdo dokument përkatës dorëzohet me shkrim në formë elektronike vetëm **përmes platformës e-Kosova**.

Parashtrimet duhet të bëhen jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së vendimit fillestar.

Komisioni i Ankesave ka për detyrë të ju përgjigjet brenda 15 ditëve. Në rastet që përfshijnë raste komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet për 15 ditë shtesë.

Ndërsa **për të gjitha çështjet tjerat** nëse besoni se jeni **ndikuar negativisht** nga Programi, atëherë mund të paraqesni një ankesë, duke plotësuar formularin e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI.

Pasi të plotësohet, formulari duhet të dërgohet në emailin zyrtar të ankesave: **ankesa.kuponat@rks-gov.net**.



Ku mund të drejtoheni nëse keni pyetje lidhur me procesin e aplikimit në Program dhe çështjet teknike?

Ju mund të drejtoheni në çdo kohë me email: **programiikuponave@rks-gov.net** dhe numrin e telefonit: **038 200 65048**.

Ku mund të ankoheni ndaj kopshtit, nëse jeni përfitues i Programit?

Nëse fëmija juaj është duke shkuar në kopsht në kuadër të Programit të Kuponëve dhe ju keni ndonjë shqetësim në lidhje me transportin ose çdo aspekt të punës dhe trajtimit të kopshtit, atëherë mund të ankoheni në çdo kohë.

Ankesat duhet të plotësohen duke përdorur formularin në faqen zyrtare të MASHTI të ofruar në të gjitha gjuhët zyrtare. Pasi të plotësohet, formulari duhet të dërgohet në emailin zyrtar të ankesave: **ankesa.kuponat@rks-gov.net**.

Ankesat do të zgjidhen brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës. Në rastet që përfshijnë çështje komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet edhe për 15 ditë të tjera.